



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0248**  
**Data e Vendimit: 05.05.2023**

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, si dhe nenin 17 paragrafi 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, me numër të protokollit 83/2020 e amendamentuar me datën 30.09.2022, pas shqyrtimit të ankesës së OE "Avokatura Istrefi" SH.P.K., me seli në Prishtinë kundër vendimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shërbime të veçanta kontraktuese për përfaqësim ligjor për nevojat e Komunës së Prishtinës" me numër të prokurimit 616-23-2375-2-2-5, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj me datën: 05/05/2023, mori këtë:

## Vendim

**Hedhet si e palejuar**, ankesa e "Avokatura Istrefi" SH.P.K. me nr. të protokollit 2023/0248 , e datës 02/05/2023, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit "Shërbime të veçanta kontraktuese për përfaqësim ligjor për nevojat e Komunës së Prishtinës", me numër të prokurimit 616-23-2375-2-2-5, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës.

Ankesa e operatorit ekonomik ankues nuk mund të shqyrtohet, pasi që e njëjta nuk është e lejuar edhe sipas nenit 4.1.26 lidhur me nenin 111 të LPP-së.

I lejohet, autoritetit kontraktues –Komuna e Prishtinës që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "Shërbime të veçanta kontraktuese për përfaqësim ligjor për nevojat e Komunës së Prishtinës", me numër të prokurimit 616-23-2375-2-2-5, përkritazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## Arsyetim

*- Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Organi Shqyrtues i Prokurimit, me 02.05.2023, ka pranuar ankesë nga OE "Avokatura Istrefi" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbime të veçanta kontraktuese për përfaqësim ligjor për nevojat e Komunës së Prishtinës" me Nr. të prokurimit 616-23-2375- 2-2-5, Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit kontraktues-AK.

Për aktivitetin prokurimit të cekur si më lartë AK me 05.04.2023 kishte publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoriteti Kontraktues.

Operatori ekonomik ankues "Avokatura Istrefi" SH.P.K., me 14.04.2023 kishte paraqitur kërkesën për rishqyrtim, e cila ishte refuzuar nga AK 24.04.2023 si e pa lejuar.

*-Vlerësimi dhe administrimi i provave -*

Organi Shqyrtues i Prokurimit konsideron se duke marr parasysh faktin, se AK kishte publikuar Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues me 05.04.2023, Ankuesi ka qenë i obliguar që në pajtim me paragrafin 3.2 të nenit 108/A të LPP-së, brenda afateve ligjore të parashtror kërkesë për rishqyrtim në AK-Komuna Prishtinës dhe vetëm pas udhëheqjes së procedurave paraprake në AK, Operatori ekonomik në pajtim me nenin 109 të LPP-së do të mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së. Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit "Shërbime të veçanta kontraktuese për përfaqësim ligjor për nevojat e Komunës së Prishtinës" me Nr. të prokurimit 616-23-2375-2-2-5, Komuna e Prishtinës -AK njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues së bashku me letrën për tenderuesin e suksesshëm e kishte publikuar me 05.04.2023, kurse kërkesa për rishqyrtim ishte paraqitur me datë 14.04.2023 apo nëntë (9) ditë më pas.

Andaj mbi bazën e të lartcekurave OSHP konstaton se AK me të drejtë e kishte refuzuar kërkesën e parashtruar nga OE "Avokatura Istrefi" SH.P.K ngase e njëjta ishte paraqitur nëntë (9) ditë pas njoftimit mbi vendim e AK (B58) që nënkupton se është paraqitur katër (4) ditë me vonesë. Kalkulim të afateve kohore, dita e publikimit të Njoftimit mbi vendimit të AK (B58) është dita (0)". Mbi bazën e të lartcekurave Ankesa e datë 02.05.2023 me (Nr. protokollit 248/23) e parashtruar në OSHP hedhet si e pa lejuar ngase Ankuesi nuk kishte parashtruar kërkesën për rishqyrtim brenda afateve ligjore. OSHP sqaron se vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake të rregullt e brenda afateve ligjore pranë AK, ankuesit mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së. Andaj konstatohet se kjo ankesë është në kundërshtim me nenin 108/A të Ligjit për Prokurim Publik dhe nenin 60 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, andaj e njëjta hedhet si e pa lejuar dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

Nga të lartcekurat, kryetarja e OSHP ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur ka të drejtë me kërkesëpadi t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

### **Vendimi t'i dorëzohet:**

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - "Avokatura Istrefi" SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: